



**Peace
Corps**
ALBANIA AND
MONTENEGRO

Raport Vjetor

Reflektime mbi partneritetet
dhe ndikimin në vitin 2025

Një post, dy shtete:
Një vit shërbim dhe bashkëpunim



Përmbajtja:

➤ Mesazh nga I Ngarkuari me Punë i SHBA-së në Mal të Zi	4
➤ Mesazh nga E Ngarkuara me Punë e SHBA-së në Shqipëri	5
➤ Fjala përshëndetëse e Drejtores për Vendin	6
➤ Misioni i Korpusit të Paqes	10
➤ Korpusi i Paqes në Shqipëri	11
➤ Korpusi i Paqes në Mal të Zi.....	12
➤ Shërbimi vullnetar në vitin 2025	13
• <i>Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi (KPSHMZ) është një post i veçantë për dy shtete</i>	15
• <i>Përfitimet e modelit të postit për dy shtete shpjegohen në vijim.....</i>	16
• <i>KPSHMZ-ja mbështet komunitetet në nevojë</i>	17
• <i>Trajnimi i Vullnetarëve gjatë shërbimit</i>	18
• <i>Vullnetarët jetojnë me familjet pritëse.....</i>	19

Përmbajtja:

➤	Vështrim i përgjithshëm i objektivave të KPSHMZ-së sipas sektorëve	20
▪	<i>Zhvillimi organizativ</i>	21
▪	<i>Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve.....</i>	22
▪	<i>Mësimdhënia e gjuhës angleze në Shqipëri.....</i>	23
▪	<i>Mësimdhënia e gjuhës angleze në Mal të Zi</i>	24
➤	Shkruaj! - Konkursi ndërkombëtar i shkrimit krijues	25
➤	Kampet verore në Shqipëri dhe Mal të Zi	26
➤	Qëndrueshmëria dhe partneritetet vendore	27
▪	<i>Bashkëpunimi me organizatat dhe grupet e interesit vendore.....</i>	27
▪	<i>Dorëzimi i trajnimit vendor.....</i>	27
▪	<i>Fuqizimi i komunitetit nëpërmjet trajnimit</i>	27
➤	Njerëzit tanë: Histori nga një homolog vullnetar	28
▪	<i>Vullnetarët ndajnë historitë e tyre.....</i>	28
▪	<i>Histori nga një homolog vullnetar</i>	29
▪	<i>Histori transformimi nga stafi</i>	30

Përmbajtja:

➤	Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar	31
	▪ <i>Përpjekje të përbashkëta për të zgjeruar rekrutimin e vullnetarëve</i>	31
	▪ <i>Buletin informativ çdo dy javë si një mjet për të mbështetur vullnetarët</i>	32
	▪ <i>Shërbimi virtual.....</i>	33
➤	Operacionet e KPSHMZ-së në mbështetje të komuniteteve pritëse dhe VKP-ve	34
	▪ <i>Mbështetja administrative efektive e operacioneve të Korpusit të Paqes</i>	34
	▪ <i>Prioritizimi i shëndetit dhe mirëqenies së vullnetarëve</i>	35
	▪ <i>Siguria dhe sigurimi i Vullnetarëve të Korpusit të Paqes</i>	36
➤	Mbështetje komunikimi për Misionin e Korpusit të Paqes	37
	▪ <i>Vullnetarët shkëmbejnë aftësi dhe njohuri me anëtarët e komunitetit</i>	37
	▪ <i>Vullnetarët ndajnë kulturën dhe traditat amerikane.....</i>	38
	▪ <i>Vullnetarët përfshihen në jetën dhe kulturën vendase</i>	39
➤	Stafi ynë i përhershëm gjatë vitit 2025	40
➤	Partnerët tanë - Çelësi i ndikimit tonë	41

Të dashur miq,

Është një privilegj të vlerësoj punën e jashtëzakonshme të Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi në mbështetje të partneritetit, arsimit dhe zhvillimit të komunitetit. Vullnetarët e Korpusit të Paqes kanë shërbyer kudo në Malin e Zi, duke punuar përkrah institucioneve vendore dhe mësuesve për të forcuar kapacitetet dhe për të promovuar mundësitë.

Me përkushtimin e tyre, Vullnetarët kanë promovuar anglishten amerikane, kanë mbështetur trajnimin e mësuesve dhe zgjeruar aksesin në arsim cilësor për të rinjtë. Prania e tyre forcon mirëkuptimin e ndërsjellët mes dy shteteve dhe lidhjet mes dy popujve tanë, që është edhe thelbi i marrëdhënies sonë dypalëshe.

Teksa Mali i Zi avancon në rrugën euroatlantike, Korpusi i Paqes vazhdon të jetë një partner i besuar për të gjithë shtetasit malazezë. Falënderoj Vullnetarët, stafin dhe familjet pritëse, përkushtimi ndaj shërbimit i të cilëve pasqyron më të mirën e vlerave tona të përbashkëta.

Përgëzime Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi për Raportin Vjetori 2025!

Me respekt, Michael C. Keays

I Ngarkuari me Punë

Mesazh nga I Ngarkuar me Punë i SHBA-së në Malin e Zi, Michael Keays



Të dashur miq,

Në vitin 2026, teksa festojmë përvjetorin e 65-së të Korpusit të Paqes dhe 250-të vjetorin e Shteteve të Bashkuara, Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi përfaqëson një shembull të gjallë të partneritetit të qëndrueshëm midis vendeve tona. Vullnetarët e Korpusit të Paqes personifikojnë të vërtetën themelore se Amerika është një vend njerëzit e të cilit janë bujarë dhe udhëheqësit e të cilit priorizojnë interesat kryesorë të amerikanëve, teksa punojnë me kombe të tjerë.

Në vitin 2025, Vullnetarët tanë kanë punuar krah për krah me komunitetet vendore, shkollat dhe organizatat e shoqërisë civile duke nxitur progres, duke sjellë inovacion dhe duke ndarë vlera. Historitë në këtë raport, qoftë në klasa, qendra rinore apo projekte komunitare paraqesin ndryshimin e vërtetë dhe afatgjatë që vjen si rrjedhojë e bashkëpunimit tonë.

Teksa Shqipëria vazhdon të forcojë institucionet e saj demokratike, Korpusi i Paqes vazhdon të jetë në qendër të këtyre përpjekjeve, duke fuqizuar individët dhe komunitetet nga baza. Këto etapa na rikujtojnë fuqinë e shërbimit dhe vlerat e përbashkëta që na bashkojnë. Jam shumë mirënjohëse për Vullnetarët tanë të përkushtuar, stafin dhe partnerët shqiptarë për përkushtimin e tyre të palëkundur. Së bashku, ne nuk po arrijmë vetëm objektivat. Së bashku ne po i japim formë një të ardhmeje më të ndritur.

Faleminderit për partneritetin tuaj!

Nancy VanHorn
E Ngarkuara me Punë

Mesazh nga E Ngarkuara me Punë e SHBA-së në Shqipëri, Nancy VanHorn



Fjala përshënd- etëse e Drejtores për Vendin: Megan Wilson

Të dashur miq,

Viti 2025 ka qenë një vit partneriteti dhe ndikimi. Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi është unik në aftësinë e tij për shfrytëzuar pikat e forta dhe bashkëpunimin me dy vendet pritëse. Ne nuk jemi dy poste të veçanta - ne jemi një: **Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi Një post, dy shtete.**

Ky raport vjetor evidenton ndikimin që kemi arritur së bashku. Megjithatë, aspekti më i fuqishëm e këtij ndikimi qëndron në lidhjet e krijuara mes Vullnetarëve tanë dhe komuniteteve ku ata shërbejnë. Këto marrëdhënie reflektojnë angazhimin tonë të përbashkët ndaj shërbimit dhe bashkëpunimit teksa përballemi me sfidat së bashku.

Në Shqipëri dhe në Malin e Zi, Vullnetarët e Korpusit të Paqes janë një pikë kryesore, që nxit gjetjen e zgjidhjeve vendore ndaj nevojave zhvillimore, duke krijuar njëkohësisht marrëdhënie miqësore. Ata punojnë përkrah anëtarëve të komunitetit për të përmirësuar mirëqenien dhe shëndetin, për t'u përshtatur me mjedisin në ndryshim dhe për të nxitur zhvillimin në bazat komunitare. Këtë vit, Vullnetarët tanë vijuan traditën e Korpusit të Paqes të fokusimit tek arsimimi dhe fuqizimi i të rinjve, duke bashkëpunuar për të krijuar drejtues dhe mundësi të reja për brezin e ardhshëm të agjentëve të ndryshimit. Puna jonë përfshin **zhvillimin organizativ, mësimdhënien e gjuhës angleze, shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve në Shqipëri dhe mësimdhënien e gjuhës angleze në Malin e Zi.**

Mesazh nga Drejtorja për Vendin

Në vitin 2025, festuam me krenari **përfundimin e dy viteve shërbim të kohortës së dytë pas pandemisë**. Dëshiroj të vlerësoj në mënyrë të veçantë punën e zellshme dhe angazhimin e Vullnetarëve tanë në Malin e Zi, përpjekjet e të cilëve kanë ngritur themele të qëndrueshme për shërbimin në të ardhmen, duke siguruar se trashëgimia e partneritetit tonë do të vijojë të lulëzojë. Po ashtu, jemi shumë të emocionuar që **katër vullnetarë nga kohorta e parë pas pandemisë kanë përfunduar shërbimin e zgjatur**. Vendimi i tyre për të qëndruar më gjatë reflekton ndikimin transformues të përvojave të tyre dhe fuqinë e shërbimit.

Ndikimi i **Vullnetarëve tanë në Malin e Zi** vazhdon të jetë i konsiderueshëm. Gjatë vitit 2025, 12 Vullnetarë të Korpusit të Paqes punuan ngushtë me të rinjtë vendas dhe mësuesit duke organizuar klube jashtëskollore të gjuhës angleze, seanca mësimdhënieje dhe kampe, në të cilat u angazhuan 382 nxënës. Në klasa, 2,486 studentë shfaqën arritje të matshme në aftësitë në gjuhën angleze, duke përforcuar arsimin si një nga gurët e themelit të misionit të Korpusit të Paqes. Me rritjen e ndërlidhjes globale, kërkesa për kompetenca të gjuhës angleze vazhdon të mbetet e lartë dhe Vullnetarët tanë po ndihmojnë në përmbushjen e kësaj kërkesë. Për më tepër, ne bashkëpunojmë me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit për të identifikuar vendqëndrimet për Vullnetarët dhe për të garantuar që përpjekjet tona të përputhen me ato të vendit pritës.

Ndikimi ynë në Shqipëri gjatë vitit 2025 reflekton fuqinë e bashkëpunimit dhe angazhimit në zhvillimin e komunitetit. Në fushën e zhvillimit organizativ, 27 Vullnetarë u lidhën me homologët vendas për të mbështetur 78 organizata komunitare, duke organizuar 397 aktivitete që nxitën angazhimin civil dhe drejtimin duke përfshirë 3190 pjesëmarrës në të gjithë komunitetet. Në fushën e shëndetit dhe mirëqenies së të rinjve, 27 vullnetarë kanë bashkëpunuar me 270 anëtarë të stafit të shkollave për të zbatuar kurrikulën inovatore për shëndetin dhe aftësitë për jetën, ku janë angazhuar 4,355 pjesëmarrës nëpërmjet trajnimeve individuale dhe në grupe të vogla. Edhe programi ynë i mësimdhënies së gjuhës angleze ka pasur shumë sukses, ku 29 Vullnetarë kanë fuqizuar 303 mësues dhe mësues ndihmës të gjuhës angleze për 6,597 nxënës në klasa, klube, kampe dhe aktivitete jashtëskollore, me pjesëmarrjen e 1,351 të rinjve të cilët pasuruan aktivitetet e zhvillimit. Këto përpjekje nxjerrin në pah angazhimin tonë të përbashkët në arsim, shëndet dhe angazhimin civil si fusha të progresit të qëndrueshëm në Shqipëri.



Mesazh nga Drejtorja për Vendin



Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të sinqertë ndaj partnerëve të komunitetit, mësuesve, prindërve, nxënësve dhe familjeve pritëse, që bashkëpunuan me Vullnetarët e Korpusit të Paqes gjatë vitit 2025. E gjitha kjo nuk do të mund të arrihej pa mbështetjen e qeverive pritëseve, konkretisht **Ministrisë së Arsimit në Shqipëri** dhe **Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit në Malin e Zi**. Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi vijon t'i qëndrojë angazhimit për përgjigjshmërinë dhe llogaridhënien ndaj partnerëve të komunitetit, forcimit të angazhimit tonë me të rinjtë dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës kritike të nevojshme për mbështetjen e shërbimit të Vullnetarëve sa i përket shëndetit, sigurisë dhe mbështetjes teknike.

Gjatë vitit 2025, ne mirëpritëm Drejtorin e ri të Programit dhe Trajnimit, **James Ayers**, i cili sjell një përvojë të pasur në zhvillim dhe njohuri rajonale, përfshirë edhe përvojën e tij si Vullnetar i Korpusit të Paqes. U urojmë gjithashtu suksese të mëtejshme kolegëve që janë larguar ose që do të vazhdojnë rrugëtimin e tyre diku tjetër, si **Melanie Ingalls** dhe Marie Aughenbaugh. Shërbimi juaj është vlerësuar dhe çmuar shumë!

Unë kam pasur nderin dhe privilegjin të shërbej si Drejtoreshë për Vendin e këtij posti unik për dy shtete që nga nëntori i vitit 2020. Këto vite kanë qenë të mbushura me tranzicion, transformim, sfida dhe frymëzim. Mbi 100 Vullnetarë janë kthyer në shërbim pas COVID-it, duke punuar në komunitete rurale në të gjithë Shqipërinë dhe Malin e Zi me mbështetje të gjerë.

Mesazh nga Drejtorja për Vendin

Së bashku kemi arritur shumë dhe unë jam jashtëzakonisht krenare për Vullnetarët tanë, komunitetet e tyre, stafin tonë dhe partnerët tonë.

Në vitin 2026 unë do të largohem nga pozicioni i Drejtores për Vendin me besimin se do të lë Korpusin e Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi në një pozicion të fortë, me një staf të dedikuar, vullnetarë frymëzues dhe komunitete dhe partnerë të përkushtuar. Pres me padurim të shoh gjithçka që ka rezervuar e ardhmja.

Ju falënderojmë për mbështetjen dhe besimin tuaj të vazhdueshëm ndaj punës sonë të përbashkët drejt paqes dhe marrëdhënieve miqësore në mbarë botën.

Me mirënjohje të thellë,



Megan Wilson
Drejtoreshë për Vendin



Misioni dhe objektivat e Korpusit të Paqes

Në vitin 1961, presidenti John F. Kennedy themeloi Korpusin e Paqes për të nxitur të kuptuarit më të mirë dhe për të promovuar miqësinë mes amerikanëve dhe popujve të tjerë.

Misioni i Korpusit të Paqes është të nxisë paqen dhe miqësinë në botë, duke përmbushur tre qëllime:

1. Të ndihmojë popullin e shteteve të interesuara të përmbushë nevojat për burra dhe gra të aftësuar.
2. Të ndihmojë në promovimin e të kuptuarit më të mirë të amerikanëve nga ana e popujve që u shërben.
3. Të ndihmojë në promovimin e të kuptuarit më të mirë të popujve të tjerë nga amerikanët.

Korpusi i Paqes ndryshon jetë; jetët e njerëzve në komunitetet në të gjithë botën dhe jetët e vullnetarëve.

- Më shumë se 240.000 amerikanë kanë shërbyer në Korpusin e Paqes në 142 vende.



Korpusi i Paqes në Shqipëri

Në vitin 1991, qeveria Shqiptare ftoi SHBA-në të krijonte një program të Korpusit të Paqes në vend. Grupi i parë i Vullnetarëve mbërriti në Shqipëri në vitin 1992 për t'u angazhuar me mësimdhënien e gjuhës angleze në shkolla të arsimit të mesëm dhe në universitete. Nga viti 1993 deri në vitin 1996, katër grupe të tjera vullnetarësh mbërritën për të dhënë mësim në anglisht, për të mbështetur zhvillimin e bizneseve të vogla ose për të mbështetur menaxhimin e bujqësisë dhe pyjeve. Korpusi i Paqes mbylli programin e tij në Shqipëri në vitin 1997 për shkak të trazirave politike dhe shqetësimeve për sigurinë e Vullnetarëve.

Qeveria shqiptare ftoi Korpusin e Paqes të rihapte programin e tij në vitin 2002 dhe mori pjesë në një vlerësim të zhvilluar nga Korpusi i Paqes. Bazuar në këtë vlerësim, anëtarët e parë të Korpusit të Paqes u kthyen në mars të vitit 2003, ngritën një zyrë dhe rihapën programet. Vullnetarët kanë punuar me qeveritë vendore, OJQ-të, shkollat dhe institucionet shëndetësore në tri fusha projekti:

- Mësimdhënia e gjuhës angleze
- Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve
- Zhvillimi organizativ

Programi i Korpusit të Paqes në Shqipëri operon sipas marrëveshjes ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë, që njeh rëndësinë e zhvillimit të marrëdhënieve të përfuturit reciprok dhe bashkëpunimit. Gjatë viteve, Korpusi i Paqes e ka çmuar thellësisht bashkëpunimin dhe dashamirësinë e popullit shqiptar. Ky partneritet është jetik për realizimin e nismave arsimore dhe zhvillimore dhe për krijimin e marrëdhënieve miqësore dhe mirëkuptimit ndërmjet kulturave. Që nga shtatori i vitit 1992, mbi 1000vullnetarë kanë shërbyer në Shqipëri.

Korpusi i Paqes në Mal të Zi

Në vitin 2019, Korpusi i Paqes nënshkroi një marrëveshje dypalëshe me qeverinë e Malit të Zi, duke bërë të mundur zbatimin e një programi në vend. Grupi i parë i Vullnetarëve në trajnim mbërriti në janar të vitit 2020 dhe filloi trajnimin 10-javor para shërbimit. Fatkeqësisht, në mars të vitit 2020, grupi u evakuua për shkak të pandemisë së COVID-19-s përpara mbërritjes në komunitetet pritëse.

Pas përgatitjeve rigoroze, Vullnetarët u rikthyen në Malin e Zi në vjeshtën e vitit 2022. Pas një periudhe trajnimi të suksesshme, ata filluan për herë të parë kryerjen e shërbimit në komunitetet malazeze. Ky rikthim përbën një triumf të rëndësishëm ndaj sfidave të hasura gjatë periudhës pararendëse prej dy vite e gjysmë, duke ringritur misionin e Korpusit të Paqes dhe duke theksuar angazhimin serioz ndaj shkëmbimit ndërkulturor dhe zhvillimit të komunitetit. Që me rikthimin në shërbim, tre grupe vullnetarësh kanë shërbyer në komunitetet malazeze. Në dhjetor të vitit 2025 kishte 11 vullnetarë në shërbim.

Programi i Korpusit të Paqes në Malin e Zi është ngritur me ftesën e qeverisë malazeze dhe operon sipas një marrëveshjeje që thekson rëndësinë e ndërtimit të marrëdhënieve me përfitim reciprok dhe bashkëpunimit. Kemi kënaqësinë të mirëpresim grupin e ri të Vullnetarëve në janar të vitit 2026 dhe të shtrijmë përpjekjet tona në komunitete të reja, duke rritur më tej ndikimin tonë dhe duke fuqizuar partneritetin tonë.

Shërbimi në vitin 2025

- 79 Vullnetarë të Korpusit të Paqes në:
 - 11 në Mal të Zi
 - 68 në Shqipëri
- 4 sektorë:
 - Mësimdhënia e gjuhës angleze në Shqipëri
 - Mësimdhënia e gjuhës angleze në Mal të Zi
 - Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve në Shqipëri
 - Zhvillimi organizativ në Shqipëri
- Vazhdimësia e partneritetit me shkollat, bashkitë, ministrinë dhe OJQ-të, dhe kalimi në emërimet në komunitete më të vogla, që kanë më pak burime.
- Vëmendja e shtuar ndaj çështjeve të lidhura me shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve, përvetësimin e gjuhës angleze dhe fuqizimin e shkollave, zhvillimin e turizmit dhe qëndrueshmërinë e projekteve nëpërmjet përgjegjësisë dhe mbështetjes vendore.





Peace Corps
ALBANIA AND
MONTENEGRO





Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi (KPSHMZ): Një post i vetëm në dy shtete



Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi vepron si një post plotësisht i integruar i cili i shërben dy shteteve të ndryshme nëpërmjet një strukture të unifikuar. Vullnetarët trajnohen së bashku gjatë trajnimit para shërbimit (TPSH), trajnimit në shërbim (TNSH), trajnimit në mes të shërbimit (TMSH), dhe e përfundojnë shërbimin e tyre në Konferencën e Përfundimit të Shërbimit (PSH). Ky model i integruar siguron qëndrueshmëri në përgatitje dhe mbështetje, duke nxitur njëkohësisht bashkëpunimin ndërkuftar.

Ndonëse i gjithë stafit ofron mbështetje për Vullnetarët në të dy shtetet, secili ekip përshtat qasjet për kontekstet unike kulturore, gjuhësore dhe arsimore të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Secili shtet ndjek programin e tij dhe ka kanale komunikimi të veçanta, të cilët reflektojnë identitetet e tyre të veçanta, por përfitojnë nga burimet dhe ekspertiza e përbashkët.



**Peace
Corps**

ALBANIA AND
MONTENEGRO



Përfitimet e modelit të postit për dy shtete shpjegohen në vijim

Një model inovator

Ky model mundëson efikasitet dhe ndikim. Duke ndërthurur operacionet Korpusi i Paqes maksimizon burimet, redukton kostot dhe arrin një raport më të lartë Vullnetar - staf. Rezultati: ndikim më i gjerë dhe angazhim më i thellë në komunitete në të dyja vendet.



KPSHMZ-ja mbështet komunitetet në nevojë



Korpusi i Paqes në Shqipëri dhe Mal të Zi vepron në të gjithë territorin e të dy shteteve, duke caktuar Vullnetarë pranë shkollave, bashkive, OJQ-ve dhe institucioneve të tjera të qeverive vendore. Në vitin 2025, KPSHMZ-ja e zgjeroi shtrirjen e tij, duke ndërvepruar me disa komunitete të reja të vogla. Duke ndjekur modelin “qendër - degë”, Vullnetarët që shërbejnë në qytete më të vegjël ose në fshatra bashkëpunojnë periodikisht në nisma rajonale, duke shfrytëzuar burimet e disponueshme në zonat më të mëdha fqinje.

Qasja jonë në caktimin e Vullnetarëve bazohet në nevoja dhe udhëhiqet nga filozofia e Korpusit të Paqes: T'i shërbejmë komuniteteve ku mungojnë burimet ose komuniteteve të nënshërbyera. Qëllimi është pajisja e anëtarëve vendorë me aftësi që do të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm, si hartimi dhe menaxhimi i projekteve, drejtimi për të rinjtë, aftësitë për jetën, njohuritë në gjuhën angleze dhe mirëqenie.

Për më tepër, Korpusi i Paqes i përshtat posaçërisht programet e tij me prioritetet kombëtare të vendit pritës. Të gjitha nismat zhvillohen në bashkëpunim me partnerët e vendit pritës dhe komunitetet vendore për të garantuar që përpjekjet e Vullnetarëve të trajtojnë nevojat vendore dhe të kenë ndikim afatgjatë.



Trajnimi i Vullnetarëve gjatë shërbimit

Vullnetarët e Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi e nisin shërbimin e tyre me një trajnim gjithëpërfshirës, Trajnimin e Orientimit dhe Para Shërbimit (TPSH), që zakonisht zgjat 10-12 javë. Programi gjithëpërfshirës, i drejtuar nga stafi i vendit pritës dhe Vullnetarët aktualë, zhvillon ekspertizën teknike, kompetencat kulturore dhe aftësitë gjuhësore. Vullnetarët në trajnim jetojnë me familjet pritëse, marrin pjesë në projekte të komunitetit dhe duhet të përmbushin standardet e kompetencave në fusha si shëndeti, siguria, komunikimi ndërkulturor dhe aftësitë në gjuhën vendase përpara se të bëjnë betimin.

Trajnimi vazhdon gjatë gjithë shërbimit të tyre dyvjeçar. Gjatë shërbimit, Vullnetarët kthehen nga vendet ku janë caktuar për workshop-e, konferenca dhe kurse online të disponueshëm në platforma si LearningSpace. Këto seanca forcojnë aftësitë gjuhësore, nxisin mirëqenien, përforcojnë protokollet e sigurisë dhe përmirësojnë aftësitë teknike, si dhe u mundësojnë Vullnetarëve të ndajnë përvojat e tyre në terren dhe të mësojnë nga kolegët.

Një gur themeli i modelit tonë të trajnimit është kurrikula e Hartimit dhe Menaxhimit të Projekteve, që bën bashkë Vullnetarët dhe anëtarët e komunitetit për të zhvilluar dhe zbatuar së bashku nismat e qëndrueshme. Këto workshop-e me pjesëmarrje ngrenë kapacitetet vendore dhe sigurojnë që projektet të përputhen me nevojat e komunitetit, duke përforcuar përgjegjësitë e përbashkëta dhe ndikimin afatgjatë.



Vullnetarët jetojnë me familjet pritëse

Jeta me familjet pritëse: Porta drejt integrimit

Vullnetarët e Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi jetojnë me familjet pritëse në komunitet ku janë caktuar **gjatë trajnimit para shërbimit** për të paktën **gjashtë muaj**. Ka raste kur, në vijim të shërbimit të tyre, Vullnetarët gjejnë opsione akomodimi të pavarura. Ndonëse jetesa e pavarur ofron fleksibilitet, jetesa me familjet pritëse është shumë e çmuar pasi përshpejton procesin e integrimit kulturor dhe të nxënies të gjuhës, si dhe mundëson të kuptuarit më të thellë të traditave vendore dhe jetës së përditshme.

Familjet pritëse u ofrojnë Vullnetarëve një tablo unike të normave të komunitetit, roleve në familje dhe zakoneve sociale, njohuri që janë të domosdoshme për shërbim të efektshëm. Kjo mënyrë organizimi nxit besimin dhe lidhjen duke i ndihmuar Vullnetarët të ndërtojnë marrëdhënie përtej vendit të punës dhe të bëhen pjesë e komunitetit. Po ashtu, kjo mënyrë rrit sigurinë dhe ofron një sistem të fortë mbështetjeje gjatë periudhës së përshtatjes. Për Vullnetarët, familjet pritëse janë më shumë se thjesht një vend për të qëndruar;

ato janë udhërrëfyes kulturorë dhe burim mbështetjeje personale. Të ngrënit së bashku, pjesëmarrja në aktivitetet familjare dhe vëzhgimi i traditave drejtpërsëdrejti u mundëson Vullnetarëve të përjetojnë jetën e pasur në Shqipëri dhe Malin e Zi në mënyra që nuk do të mund t'i përjetonin nëse nuk do të jetonin me familjet. Nga këto marrëdhënie shpesh krijohen lidhje që zgjatin gjatë gjithë jetës, duke përforcuar misionin e Korpusit të Paqes për të nxitur të kuptuarit ndërkulturor.



Një Vullnetar me nënën pritëse

Objektivat e vitit 2025 sipas sektorit

Edukimi shëndetësor

- 1: Shtimi i njohurive dhe aftësive të fëmijëve dhe të rinjve** për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e tyre përmes edukimit shëndetësor dhe aftësimit për jetën.
- 2. Shtimi i kapaciteteve të stafit shkollor** për të edukuar rreth shëndetit dhe aftësive për jetën.
- 3. Zhvillimi dhe shtimi i bashkëpunimit** me ofruesit e shërbimit dhe partnerët e komunitetit për të mbështetur në mënyrë të efektshme shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve.

Zhvillimi organizativ

- 1. Fuqizimin e kapaciteteve** të organizatave për të përmirësuar shërbimet që u ofrojnë anëtarëve të tyre.
- 2. Fuqizimin e kapaciteteve** të organizatave për të ofruar zhvillim profesional dhe mundësi angazhimi qytetar për anëtarët e komunitetit.

Mësimdhënia e gjuhës angleze

- 1. Rritja e kompetencave në gjuhën angleze** dhe e kapacitetit për përdorimin e gjuhës angleze dhe praktikave të mësimdhënies me barazi gjinore.
- 2. Shtimi i arritjeve të nxënësve** në gjuhën angleze dhe përforcimi i aftësive për jetën.
- 3. Rritja e aftësisë së anëtarëve të komunitetit** për të mbështetur aksesin e nxënësve të nxënësve të nxënësve.

Projektet e KPSHM-së: Zhvillimi organizativ (ZHO)

Qëllimi i Projektit: Menaxhimi efektiv i zhvillimit të komunitetit nga individët, organizatat dhe komunitetet e fuqizuara shqiptare.

Projekti i KPSHM-së për zhvillimin organizativ synon të fuqizojë kapacitetin organizativ në nivel vendor përmes caktimit të Vullnetarëve në punë në agjenci qeveritare dhe OJQ. Vullnetarët promovojnë qasje të mbështetura në vlera për zhvillimin e komunitetit, angazhimin e shoqërisë civile, qeverisjes së mirë dhe krijimin e lidhjeve mes palëve të interesit.

Histori suksesi: Gjysmë maratona e Kukësit

Në bashkëpunim me organizatën e tij *Center for Youth Progress [Qendra për Progres Rinor]* në Kukës, VKP Benjamin organizoi gjysmë maratonën e parë në këtë qytet. Eventu synonte të evidentonte vlerat kulturore, turistike dhe historike të qarkut të Kukësit dhe ta poziciononte atë në hartën turistike sportive të Shqipërisë.

Për më tepër, gjysmë maratona promovoi jetesën e shëndetshme, si dhe bëri bashkë të rinj nga Kukësi, por edhe nga qarqet e tjera të Shqipërisë. Motoja e saj ishte:

“Çdo hap është histori, çdo vrapues është frymëzim.”

Ky event historik u organizua me kontributin e më shumë se 70 vullnetarëve, të drejtuar nga VKP Benjamin dhe homologët e tij. Duke parë suksesin e saj është planifikuar që gjysmë maratona të kthehet në një traditë e përvitshme.

Ndikimi

Kjo nismë nxiti një model komunitar të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, duke rritur potencialin turistik, forcuar lidhjet brenda komunitetit dhe përmirësuar cilësinë e jetës për banorët e Kukësit.



- 27** Vullnetarë shërbyen në këtë sektor gjatë vitit 2025.
- 78** organizata komunitare të mbështetura nga Vullnetarët për të zgjeruar mundësitë për angazhim qytetar.
- 3,190** pjesëmarrës në aktivitete vullnetare të organizuara nga Vullnetarët dhe homologët e tyre.
- 397** aktivitete të zbatuara nga Vullnetarët e OZH-së dhe Homologët.

Projekti i KPSHMZ-së: Shëndeti dhe mirëqenia e të rinjve

Qëllimi i Projektit: Fuqizimi dhe informimi i fëmijëve dhe të rinjve për të pasur një jetë të shëndetshme dhe për t'u kthyer në të rritur produktivë dhe të përkushtuar.

Duke i caktuar Vullnetarët në shkollë për të punuar krahe mësuesve dhe homologëve të komunitetit, projekti për edukimin mbi shëndetin synon të rrisë njohuritë dhe aftësitë e fëmijëve dhe të rinjve me qëllim përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tyre, rritjen e kapaciteteve të stafit shkollor për të ofruar edukim mbi shëndetin dhe aftësitë për jetën dhe rritjen e bashkëpunimit me ofruesit e shërbimit dhe partnerët komunitarë.

Ndikimi : Deri në përfundim të vitit shkollor, VKP-të e angazhuar në edukimin shëndetësor kontribuan në përmirësimin e njohurive dhe aftësive të 1,056 fëmijëve, të rinjve dhe anëtarëve të komunitetit mbi të ngrënit të shëndetshëm, aktivitetit fizik dhe ndërgjegjësimin mjedisor. 3,378 fëmijë, të rinj dhe anëtarë të komunitetit shfaqën përmirësim të shëndetit dhe mirëqenies gjatë edukimit shëndetësor.

Histori suksesi: Krijimi i një mjedisi arsimor dinamik dhe gjithëpërfshirës dhe integrimi i efektshëm i teknologjisë në praktikat e mësimdhënies dhe të nxënit - Nga të nxënit klasik në të nxënit modern - projektit "Get Digitalized" [Digjitalizohu]. VKP-ja Adrell dhe homologu i saj trajnuan mësuesit dhe nxënësit duke inkorporuar teknologjinë në orët mësimore për të gjitha lëndët, gjë që në vijim do të përmirësojë përvojën e të nxënit për nxënësit.

Aktivitetet

Sipas trajnimit Hartim dhe Menaxhim Projekti të organizuar nga KPSHMZ, Adrell dhe homologët e saj bashkëpunuan për të realizuar propozimin e projektit për sallën e teknologjisë. Puna e tyre në krijimin e sallës së teknologjisë në shkollë dhe mbështetja ndaj mësuesve ka nxitur një entuziazëm të ri te nxënësit, shumë prej të cilëve po eksplorojnë aftësitë digjitale për herë të parë. Këto kontribute do të ndërtojnë themele më të forta të të nxënit dhe një të ardhme më të ndritur në të gjithë komunitetet ku ne shërbejmë.



27 Vullnetarë shërbyen në këtë sektor gjatë vitit 2025

270 punonjës nga stafi i shkollave u orientuan drejt përdorimit të teknikave novatore për të lehtësuar kurrikulat me barazi gjinore për shëndetin dhe aftësitë për jetën

4,355 pjesëmarrësve iu ofrua trajnim individual ose në grup mbi shëndetin dhe mirëqenien e të rinjve

Projekti i KPSHMZ-së: Mësimdhënia e gjuhës angleze në Shqipëri

Qëllimi i Projektit: Zhvillimi i kapaciteteve të mësimdhënies dhe të nxënimit të gjuhës angleze për nxënësit dhe mësuesit shqiptarë. Programi i mësimdhënies së gjuhës angleze në Shqipëri synon të përmirësojë njohuritë gjuhësore të nxënësve dhe mësuesve, të forcojë aftësitë e mësuesve si në pedagogjinë e përgjithshme, ashtu edhe në mësimdhënien e gjuhës angleze dhe të fuqizojë anëtarët e komunitetit shkollor që të mbështesin në mënyrë aktive të nxënimit e nxënësve.

Modeli Bashkimi Evropian - Zhvillimi i aftësive drejtuese dhe gjuhësore

Në maj të vitit 2025, Vullnetarët e mësimdhënies së gjuhës angleze në bashkëpunim me mësuesit shqiptarë organizuan Konferencën Përfundimtare të Modelit të Bashkimit Evropian (MBE), pas disa muajsh përgatitje nga klubet MBE në të gjithë vendin.

Për këtë event u angazhuan 106 nxënës nga 11 shkolla, të cilët përfaqësonin 14 shtete anëtare të BE-së dhe Korpusin e Shtypit, në tre debate të simuluar të Komitetit të Bashkimit Evropian. Pjesëmarrësit diskutuan problematikat prioritare të BE-së, negociuan për rezolutat dhe praktikuan të folurit në publik dhe punën në ekip në një mjedis dinamik.

Kjo nismë jo vetëm që thelloi të kuptuarit e nxënësve për Bashkimin Evropian dhe proceset e tij vendimmarrëse, por i ndihmoi edhe të zhvillonin aftësi thelbësore si drejtimi, mendimi kritik dhe një nivel të avancuar të zotërimit të gjuhës angleze. Për mësuesit e gjuhës angleze, MBE-ja u kthye në një mjet të çmuar për të mbështetur zhvillimin gjuhësor nëpërmjet të nxënimit nga përvoja.



Mësuesja e gjuhës angleze Rexhina dhe Vullnetari Robert fuqizojnë lexuesit me më shumë libra në këndin e leximit të shkollës.

- 29** Vullnetarët shërbyen në sektorin e mësimdhënies së gjuhës angleze në vitin 2025
- 303** mësues morën mbështetje në klasë dhe jashtë saj nëpërmjet trajnimeve dhe konferencave
- 1,351** të rinj morën pjesë në aktivitetet për zhvillimin e të rinjve, organizuar nga Vullnetarët dhe homologët vendas
- 6,597** nxënësve iu ofrua mësimdhënie e përbashkët e gjuhës angleze në klasa dhe klube, kampe apo aktivitete jashtëshkollore

Projekti i KPSHMZ-së: “TEFL” në Mal të Zi

Qëllimi i Projektit: Zhvillimi i kapaciteteve të mësimdhënies dhe të nxënimit të gjuhës angleze për mësuesit dhe nxënësit malazezë.

Përgjatë programit TEFL, Vullnetarët caktohen në shkolla në të gjithë Malin e Zi si bashkëmësues përkrah mësuesve vendas të gjuhës angleze, me synimin për të përmirësuar njohuritë e gjuhës angleze të nxënësve duke krijuar mjedise mësimore dinamike dhe tërheqëse. Përtej mbështetjes në klasë, Vullnetarët organizojnë edhe aktivitete jashtëshkollore dhe projekte komunitare që u ofrojnë të rinjve vendas mundësi për të zhvilluar aftësitë e drejtimit dhe aftësitë për jetën.

Histori suksesi - Të nxënimit e gjuhës angleze përtej mureve të klasës

Pasi filluan shërbimin në bashku në prill të vitit 2025, Vullnetarja e Korpusit të Paqes Kara dhe homologia e saj Slavka eksplorojnë me entuziazëm mënyra për ta sjellë përdorimin e gjuhës angleze në jetë në klasë, mes mësuesve dhe në komunitet. Dëshira për të përmirësuar aftësitë gjuhësore dhe të komunikimit nuk kufizohet vetëm te nxënësit në klasë. Prindërit që praktikojnë gjuhën angleze u tregojnë nxënësve rëndësinë e zotërimit të një gjuhe të dytë. Mësuesit e të gjitha lëndëve tregojnë guxim kur flasin anglisht, veçanërisht nëse nuk është fusha ose pika e tyre e fortë. Profesionistët e komunitetit të cilët kërkojnë mënyra për të praktikuar gjuhën angleze tregojnë nevojën për të përmirësuar aftësitë gjuhësore, gjë nga e cila përfitojnë të gjithë malazezët.

Duke parë interesin e madh në zotërimin e gjuhës angleze, Kara dhe Slavka iu përgjigjën thirrjes duke drejtuar pesë klube të gjuhës angleze; një në shkollë për nxënësit e tyre, një në komunitet që është i hapur për të gjithë nxënësit, dy opsione për mësuesit gjatë ditës së punës dhe një klasë pasdite që është e hapur për të gjithë të rriturit e komunitetit. Të gjitha klubet përqendrohen në normalizimin e gabimeve gjatë të folurit, krijimin e besimit për të provuar, kreativitetin në mënyrën e shprehjes së ideve, eksplorimin e komunikimit joverbal dhe të dëgjuarit e njëri-tjetrit pa gjykuar. Të gjithë janë të mirëpritur të marrin pjesë.



Kara duke dhënë mësim në klubin e saj

11 Vullnetarë shërbyen në këtë sektor gjatë vitit 2025
382 nxënës morën pjesë në klubet jashtëshkollore të gjuhës angleze, seancat mësimore, dhe/ose kampet
2,486 nxënës në klasat e Vullnetarëve treguan arritjet e tyre në gjuhën angleze.

Shkruaj!

- Konkursi ndërkombëtar i shkrimit krijues

Përveç mbështetjes së drejtpërdrejtë për mësuesit dhe nxënësit në klasa, Vullnetarët e mësimdhënies së gjuhës angleze realizojnë aktivitete që fuqizojnë dhe frymëzojnë krijimtarinë e nxënësve dhe i mësojnë atyre aftësitë e të menduarit kritik.

Këtë vit, me drejtimin e Vullnetarëve të mësimdhënies së gjuhës angleze, 1,045 nxënës nga 21 komunitete praktikuan aftësitë e tyre të shkruarit, u frymëzuan për të qenë krijues dhe garuan me bashkëmohatarët e tyre në Shqipëri dhe më tej. Për mësuesit e anglishtes kjo ishte një mundësi për të zhvilluar aftësitë e nxënësve të tyre në gjuhën angleze nëpërmjet mënyrave që nxisin të menduarit të cilat shpesh nuk përfshihen në kurrikulë, dhe çfarë është më e rëndësishmja, Shkruaj! i dha mundësinë nxënësve të shprehen lirisht dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre në gjuhën angleze.

Në vitin 2025, Shqipëria mori rolin e organizatores ndërkombëtare të Shkruaj! 111 fituesit në nivel kombëtar nga Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut, Armenia dhe Gjeorgjia morën pjesë në konkursin ndërkombëtar, në të cilin 10 nga fituesit ishin nga Shqipëria dhe Mali i Zi. Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi është shumë krenar për këtë projekt dhe po planifikon ta zgjerojë atë në më shumë komunitete dhe shtete.



1,045 nxënës morën pjesën
21 komunitete morën pjesë

111 fitues kombëtarë nga Shqipëria, Mali i Zi, Kosova, Maqedonia e Veriut, Armenia dhe Gjeorgjia

Kampet verore të VKP-ve të KPSHMZ-së

Gjatë muajve të verës Vullnetarët e KPSHMZ janë angazhuar në mënyrë aktive në zhvillimin e aktiviteteve krijuese me fëmijët dhe të rinjtë. Një tipar kyç i këtyre përpjekjeve janë kampet verore, të cilat përfshijnë planifikim të kujdesshëm, bashkëpunim dhe zbatimin me aktorë të ndryshëm të komunitetit.

Histori suksesi: Vajzat drejtojnë botën nëpërmjet kodimitKampet verore GLOW Code hynë në vitin e tyre të tretë në 2025. Një program dyjavor gjatë së cilit vajzat mësojnë për kodimin, teksa zhvillojnë aftësitë e drejtimit; kampet ofrojnë një mjedis argëtues dhe tërheqës për pjesëmarrësit për të ndërtuar një bazë të fortë të vlerave pozitive.

Këtë vit “GLOW Code” lançoi dy nisma të reja:

GLOW Code+ është një program njëjavor i avancuar i projektuar për të zhvilluar më tej aftësitë teknike dhe të drejtimit të ish-nxënësve tonë. Pjesëmarrësit u prezantuan me JavaScript dhe përforcuan të kuptuarit e HTML dhe CSS.

GLOW Code Connect synoi të zhvillonte më tej kapacitetet e instruktorëve të teknologjisë në kamp, duke mundësuar lidhjen e tyre me mentorë profesionistë të TIK-ut në Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara.

Mentorët të cilët punojnë në firma si Microsoft, HP, Lime Micromobility dhe Clay ofruan drejtimin në distancë dhe mundësuan zhvillimin profesional të instruktorëve tanë.

Temat e mbuluara gjatë kampit përfshijnë:

Prezantimin me drejtimin dhe kodimin, komunikimin dhe punën në ekip.

Projektimin e produktit nëpërmjet planifikimit të qytetit.

Krijimin e marrëdhënieve pozitive dhe vendosjen e objektivave SMART.

Zhvillimin e aftësive plotësuese si të folurit në publik dhe komunikimi i efektshëm.



11 qarqe/qytete në të gjithë Shqipërinë.

146 nxënës janë angazhuar në kampe.

29 Instruktorë

17 Instruktorët e teknologjisë

28 GLOW Code+ pjesëmarrësit e kampit

4 GLOW Code+ kampet e zhvilluara

Qëndrueshmëria dhe partneritetet vendore

Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi i jep prioritet qëndrueshmërisë duke nxitur partneritete të forta vendore dhe duke fuqizuar komunitetet për të udhëhequr nisma zhvillimore. Modeli ynë siguron që përpjekjet e Vullnetarëve të përkthehen në ndikim afatgjatë nëpërmjet bashkëpunimit, ngritjes së kapaciteteve dhe përgjegjësisë së përbashkët.

Bashkëpunimi me organizatat dhe grupet e interesit vendore

Në bashkëpunim ngushtë me institucione kombëtare dhe rajonale, përfshirë Ministrinë e Arsimit të Shqipërisë dhe Malit të Zi, Zyrrat Rajonale të Arsimit dhe Shoqatat e Mësuesve të Gjuhës Angleze. Partneritetet shtrihen edhe në bashki, organizatat e shoqërisë civile dhe këshillat rinorë, duke krijuar një rrjet të gjerë mbështetjeje për projekte të udhëhequra nga komuniteti.

Dorëzimi i trajnimit vendor

Të përshkallëzosh ndikimin do të thotë të trajnosh trajnuesit e të ardhmes. Një shembull tipik është programi GLOW Code, ku ish-pjesëmarrësit e kampeve të kodimit të bashkëdrejtuar nga Vullnetarët, tashmë janë kthyer si instruktorë, duke shumëfishuar ndikimin e nismave për njohuritë digjitale.

100% e aktiviteteve të Vullnetarëve drejtohen bashkërisht me partnerët vendorë.

Fuqizimi i komunitetit nëpërmjet trajnimit

Korpusi i Paqes investon në forcimin e kapaciteteve vendore nëpërmjet programeve të synuara të tranimit:

Trajnimet e familjeve pritëse përmirësojnë shkëmbimin kulturor dhe integrimin me komunitetin.

Konferencat e Partnerëve pajisin partnerët vendorë me mjetet e duhura për bashkëpunim të efektshëm.

Workshop-et e Hartimit dhe Menaxhimit të Projekteve (HMP) janë të hapur për organizatat vendore duke i mundësuar atyre të hartojnë dhe zbatojnë projekte të qëndrueshme.

Duke integruar njohuritë dhe drejtimin në komunitete, Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi garanton se nismat tona do të vazhdojnë të jenë të suksesshme edhe pas shërbimit të Vullnetarëve. Kjo qasje pasqyron angazhimin tonë ndaj prioriteteve vendore, përgjegjësisë së përbashkët dhe ndikimit të qëndrueshëm.



Njerëzit tanë - Vullnetarët ndajnë historitë e tyre

Historia e Sarah-ës: “Nuk është kurrë vonë për të shërbyer”


Kur Sarah T. aplikoi në Korpusin e Paqes në moshën 68 vjeçare, ajo kishte dyshime nëse do të mund të përballonte sfidat e shërbimit. Por filozofia e saj që e kishte shoqëruar gjithë jetën “njerëzit në radhë të parë”, trajtimi i të gjithëve me dashamirësi, empati dhe respekt e çoi atë drejt këtij vendimi. E inkurajuar nga familja dhe e siguruar se Korpusi i Paqes vlerëson përvojën që sjellin personat në moshë më të madhe, Sarah dorëzoi aplikimin e saj dhe filloi një kapitull të ri me një qëllim.

Sot Sarah jep mësim në gjuhën angleze në një qytet malor rural të Malit të Zi. Ajo ka zbuluar dashurinë për mësimdhënien dhe ka ndërtuar lidhje të forta me nxënësit dhe kolegët. Nga zgjerimi i klubit të teatrit në shkollë te organizimi i një panairi arti dhe drejtimi i një programi veror për gjuhën angleze, Sarah ka dhënë kontribute të rëndësishme. Megjithatë, për të, suksesi nuk matet nga arritjet, por nga marrëdhëniet.

Gjatë trajnimit na u tha: “Nëse filloni me marrëdhëniet, çdo gjë tjetër do të vijë pas”. Për mua, ky është një zgjatim i filozofisë sime prej shumë kohësh “njerëzit në radhë të parë”, shprehet Sarah. Përvoja e saj tregon se shërbimi nuk njih kufi moshe. Nëpërmjet lidhjes dhe shkëmbimit kulturor, Sarah ka gjetur atë që kërkonte: *qëllimin, komunitetin dhe kënaqësinë e të bërit ndryshimin.*



*Vullnetarja e Korpusit të Paqes
Gjatë kampit veror dhe në ceremoninë e betimit.*



Njerëzit tanë – Homologia Hike tregon historinë e bashkëpunimit të saj me Vullnetaren e Korpusit të Paqes Abigail

Bashkëpunimi im me Korpusin e Paqes ishte një përvojë krejtësisht e re për mua dhe, si çdo fillim i ri, fillimisht erdhi me disa frikëra dhe pasiguri. Mbaj mend mirë takimin tim të parë me Abigail dhe nervozizmin që ishte qartësisht i dukshëm në shprehinë time. Pyesja veten nëse do të kisha sukses dhe nëse kjo përvojë do të forconte praktikën e mia mësimore, apo do të shtonte pasiguritë e mia. Të gjitha këto pyetje morën përgjigje shumë shpejt. Që nga fazat e para të punës dhe përshtatjes me Abi-n, kuptova se gjithçka do të ishte shumë më e lehtë dhe më e këndshme sesa kisha parashikuar. E konsideroj veten me fat që kam punuar pranë një personi kaq pozitiv, të përkushtuar dhe të ngrohtë. Përgjegjësitë tona të mësimdhënies dhe sfidat e përditshme u menaxhuan natyrshëm, dhe gjatë gjithë kohës ne kemi mbështetur dhe plotësuar njëra-tjetrën. Besoj se empatia ime dhe përshtatshmëria e Abi-t ishin dy cilësitë kyç që kontribuuan ndjeshëm në bashkëpunimin tonë të suksesshëm.

Megjithëse dy vitet kaluan shpejt, ajo që ka më shumë rëndësi është se gjatë kësaj kohe ne jo vetëm që shkëmbyem ide, tradita dhe përvoja, por gjithashtu zhvilluam një qasje më të efektshme mësimore, nga e cila nxënësit tanë do të vazhdojnë të përfitojnë, veçanërisht përmes komunikimit të vazhdueshëm në anglisht gjatë orëve mësimore, që ata e shijojnë shumë, si dhe përmirësimit të dukshëm të aftësive të tyre të të folurit dhe shqiptimit.

Mund të flas gjerë e gjatë për këtë përvojë të paharrueshme dhe shumë kuptimplotë. Për gjithë këtë, dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të sinqertë ndaj Arditës dhe Agimit nga Korpusi i Paqes, të cilët më ka ofruar vazhdimisht mbështetje dhe motivim gjatë gjithë bashkëpunimit tonë.

Faleminderit vërtet shumë!

Mësuesja Hike



Mësueset Abigail dhe Hike bashkëpunuan me sukses në vitin 2025

Njerëzit tanë - Histori transformimi nga stafi “Kur gjen veten te të tjerët”

Gjatë vitit 2025, një nga anëtarët e përkushtuar të stafit tonë, Ilir Ziu, ndau një reflektim tejet personal me postimin e tij “Kur gjejmë veten te të tjerët” në faqen e internetit të Korpusit të Paqes. Pasi kishte menduar fillimisht të emigronte, Iliri zbuloi qëllimin e ri pasi iu bashkua stafit të Korpusit të Paqes. Ai ia atribuon angazhimit të Vullnetarëve rikthimin e shpresës, duke e transformuar nga dikush që kërkonte të largohej nga vendi në një person që po të ndërton një të ardhme më të ndritur në atdhe.




*Iliri gjatë
TPSH-së*

Histori e Ilirit na rikujton se misioni i Korpusit të Paqes nuk prek vetëm komunitet, por transformon edhe ata që shërbejnë. Sot Iliri punon me krenari për të forcuar partneritetet, nxitur të kuptuarit, duke vërtetuar se shërbimi sjell ndryshim afatgjatë në çdo nivel.

Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar: -Zgjerimi i rekrutimit të Vullnetarëve-

Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi forcoi përpjekjet e tij të rekrutimit në vitin 2025 duke shfrytëzuar zërat dhe përvojat e Vullnetarëve aktualë dhe të rikthyer. Përmes nismës “Brand Ambassador”, vullnetarët nga programet e Shqipërisë dhe Malit të Zi u angazhuan në mënyrë aktive me kandidatët e mundshëm, duke ndarë histori autentike shërbimi dhe ndikimi. Ndarja e përvojës në vetën e parë i dha atyre informacione të vlefshme për jetën si Vullnetarë dhe nxiti interes te individët që po kërkojnë mundësi kuptimplota për të kontribuar në zhvillimin e komunitetit.

Për të plotësuar këto përpjekje, posti përforcoi strategjinë e tij të arritjes përmes mesazheve të synuara në mediat sociale. Duke përdorur mesazhet e përshtatura dhe ndërvepruese, Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi shtoi ndërverpimin me aplikantët e mundshëm në platformat digjitale. Kjo qasje jo vetëm që ka zgjeruar vizibilitetin, por edhe ka nxitur lidhjet direkte me të interesuarit për të qenë vullnetarë, duke siguruar që procesi i rekrutimit të përputhet me misionin e organizatës dhe nevojat e komuniteteve pritëse.



Intervistat mes kolegëve të krijuara nga Vullnetarët në 2025 përshkruan shërbimin në Shqipëri dhe Malin e Zi dhe ishin vetë Vullnetarët që iu përgjigjen pyetjeve drejtpërsëdrejti.

Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar: Buletin Informativ çdo dy javë si një mjet për të mbështetur vullnetarët

Shërbim i rikonceptuar

Komunikimi i përmirësuar për të mbështetur Vullnetarët

Në vitin 2025, Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi shfrytëzoi buletin informativ dyjavor për të gjithë Vullnetarët dhe stafin si kanal komunikimi kyç për të forcuar lidhjet me Vullnetarët në të dy shtetet. Kjo nismë ofron për vullnetarët përditësime të rregullta, mbështetje në kohë dhe vizibilitet të plotë për aktivitetet e KPSHMZ. Ky buletin informativ shërben si platformë për të ndarë njoftime të rëndësishme, burime dhe mundësi, duke nxitur ndjenjën e përkatësisë dhe bashkëpunimit. Duke qëndruar në komunikim të vazhdueshëm, Korpusi i Paqes përforcon angazhimin e tij ndaj mirëqenies së Vullnetarëve dhe suksesit të programit.



Ky buletin informativ dyjavor dërgohet në adresat elektronike të të gjithë Vullnetarëve

- 20** Buletinë informativë forcuan transparencën, mbështetën suksesin e Vullnetarëve dhe përforcuan frymën bashkëpunuese mes stafit dhe Vullnetarëve.
- 400** faqe me foto, histori dhe përditësime që mbulojnë një sërë temash: siguria dhe shëndeti, arritjet e programit, njoftime administrative, informacione kulturore, mundësi financimi dhe arritjet e Vullnetarëve.

Modele novatore shërbimi dhe shërbim i rikonceptuar: -Shërbimi virtual-

Nisma për shërbim virtual:

Në vitin 2020, Korpusi i Paqes prezantoi Platformën Pilot për Shërbime Virtuale (PPSHV) si një mënyrë novatore për të vazhduar misionin dhe synimet e KP-së edhe gjatë pandemisë së COVID-19. PPSHV-ja u projektua për të provuar realizueshmërinë e angazhimit virtual dhe si fillim ishte e hapur për çdo Vullnetar të Kthyer të Korpusit të Paqes. Kohët e fundit, angazhimet e Shërbimit Virtual janë të hapura për të gjithë qytetarët amerikanë që dëshirojnë të ofrojnë shërbimet e tyre vullnetare. Pjesëmarrësit në Platformën Pilot për Shërbime Virtuale (PPSHV) janë qytetarë, që ia ofrojnë kohën dhe shërbimet e tyre vullnetare agjencisë për t'u bërë virtualisht pjesë e angazhimeve pesë deri në pesëmbëdhjetë orë në javë me partnerë të komunitetit për një periudhë prej tre deri në gjashtë muaj.

Shërbimi virtual në Shqipëri dhe Mal të Zi:

Që në fillim të Platformës Pilot për Shërbime Virtuale në vitin 2020, Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi ka krijuar 13 angazhime për Shërbime Virtuale në bashkëpunim me organizata partnere vendase në të dyja vendet. Këto angazhime i kanë mundësuar KPSHMZ-së të krijojë partneritete dhe të mbështesë partnerët aktualë e organizatat partnere në Tiranë ose Podgoricë, ku VKP-të nuk mund të shërbejnë.

Trembëdhjetë individët, që ia kanë dedikuar kohën e tyre shërbimit virtual, kanë kontribuar në aktivitete të lidhura me zhvillimin e kurrikulës, përvetësimin e gjuhës angleze, zhvillimin e drejtuesve, mbledhjen e fondeve, e shumë të tjera. Që prej janarit të vitit 2024, janë në proces zbatimi tre angazhime për Shërbime Virtuale.



Mundësitë e shërbimit virtual

- 12** angazhime për Shërbime Virtuale në Shqipëri dhe Mal të Zi që nga fillimi i pilotimit me shkollat, institucionet e arsimit të lartë, OJQ-të dhe agjencitë qeveritare.
- 1** Angazhimi me Shërbimin Virtual ishte pjesë e programit tonë më Malin e Zi gjatë

Mbështetja administrative efektive e operacioneve të Korpusit të Paqes

Prapaskenat: Mbështetja e shërbimit të Vullnetarëve

Suksesi i Korpusit të Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi nuk varet vetëm nga përkushtimi i Vullnetarëve, por edhe nga mbështetja e fortë e ofruar nga ekipi ynë i Menaxhimit dhe Operacioneve. Ky ekip siguron që shumë aspekte, nga transporti i anëtarëve të ekipit te menaxhimi financiar, të trajtohen me përpikëri dhe Vullnetarët të përqendrohen te misioni i tyre.

Stafi ynë administrativ dhe logjistik punon pa u lodhur për të siguruar akomodim të sigurt, për të organizuar transport të besueshëm dhe për të menaxhuar sigurimin e burimeve të domosdoshme. Ekipi i financave siguron përputhshmërinë me rregulloret e SHBA-së dhe të vendit pritës, duke ofruar mbikëqyrje financiare transparente dhe efikase. Këto përpjekje garantojnë që operacionet të zhvillohen pa probleme dhe që Vullnetarët të kenë mjetet që u nevojiten për të qenë të suksesshëm në komunitetet e tyre.

Përtej këtyre, ekipi ruan partneritete të forta me furnitorë vendorë, ofruesit e shërbimeve dhe agjencitë qeveritare. Menaxhimi dhe operacionet janë themeli i besimit dhe besueshmërisë. Puna e tyre mund të kryhet në prapaskenë, por është e domosdoshme për misionin e Korpusit të Paqes - Dhënia e mundësisë Vullnetarëve që të shërbejnë në mënyrë të efektshme dhe të sigurt në Shqipëri dhe Malin e Zi.



Gjatë vitit, stafi merr pjesë në trajnime të vazhdueshme, por edhe në aktivitete për mirëqenien.

Prioritizimi i shëndetit dhe mirëqenies së vullnetarëve

Në qendër të çdo gjëje që ne bëjmë qëndron shëndeti, siguria dhe mirëqenia e Vullnetarëve tanë. Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi siguron mbështetje mjekësore gjithëpërfshirëse gjatë gjithë periudhës së shërbimit, duke garantuar që Vullnetarët të fokusohen në misionin e tyre të qetë dhe me vetëbesim. Që nga momenti i mbërritjes, Vullnetarët marrin trajnim të plotë për shëndetin dhe sigurinë gjatë Trajnimit Para Shërbimit, duke përfshirë kujdesin parandalues, ushqyerjen, shëndetin mendor dhe procedurat emergjente.

Ekipi ynë i përkushtuar mjekësor ofron **akses 24/7 në kujdes**, kontrole rutinë shëndetësore dhe shërbime për reagim në rast emergjence. Vullnetarët pajisen me kuti të ndihmës së shpejtë, mbështeten përmes konsultave të rregullta dhe kanë akses në ofruesit vendorë dhe rajonalë të kujdesit shëndetësor sipas nevojës. Duke marrë në konsideratë se mirëqenia emocionale është po aq e rëndësishme sa shëndeti fizik, janë vënë në dispozicionin edhe burimet dhe këshillimi për shëndetin mendor.



Duke prioritzuar kujdesin proaktiv dhe reagimin e shpejtë, Korpusi i Paqes siguron që Vullnetarët të jenë të shëndetshëm, të sigurt dhe të mbështetur gjatë gjithë shërbimit të tyre. Ky angazhim pasqyron besimin tonë thelbësor: kur vullnetarët ndihen të sigurt dhe mbështetur, ata mund të angazhohen plotësisht me komunitetet e tyre dhe të kenë ndikim afatgjatë.

Mbështetja e sigurisë dhe sigurimit të VKP-ve

Ekipi i Sigurisë dhe Sigurimit priorizon vazhdimisht mirëqenien e Vullnetarëve dhe Vullnetarëve në trajnim, duke ofruar mbështetje gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme gjatë gjithë shërbimit të tyre. Ekipi siguron që Vullnetarët të marrin mbështetje 24/7 për çdo shqetësim lidhur me sigurinë dhe sigurimin, duke ofruar udhëzime të menjëhershme dhe ndërhyrje gjatë emergjencave, si katastrofat natyrore, trazirat civile ose incidente të tjera të sigurisë. Ai mirëmban sistemet kryesore në mënyrë që Vullnetarët të mund të mbështeten gjithmonë në komunikim dhe mbështetje në kohë. Përveç mbështetjes direkte të Vullnetarëve, Ekipi i Sigurisë dhe Sigurimit bashkëpunon edhe me autoritetet vendore për të garantuar sigurinë e Vullnetarëve dhe për të ruajtur sigurinë në ambientet e komuniteteve pritëse.

Për të forcuar gatishmërinë, ekipi ofron trajnime mbi sigurinë gjatë gjithë periudhës dyvjeçare të shërbimit për t'i ndihmuar Vullnetarët tanë të përgatiten për të reaguar ndaj emergjencave. Për të reduktuar risqet kryhen vlerësimet të rregullta të riskut, ku përfshihet edhe vlerësimi i kushteve të akomodimit gjatë përgatitjes në terren. Gjithashtu, vullnetarët marrin paralajmërime proaktive për sigurinë për t'u informuar për situatën në rrethanat e tyre.



Ekipi i Sigurisë dhe Sigurimit duke ofruar trajnime për Vullnetarët

Vullnetarët shkëmbejnë aftësi dhe njohuri me anëtarët e komunitetit

Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi fuqizojnë Vullnetarët që të kenë ndikim kuptimplotë, duke i siguruar mjetet, burimet dhe kanalet e komunikimit që forcojnë partneritetet dhe përforcojnë objektivat e zhvillimit. Ne i mbështesim ata edhe përmes ndarjes së historive dhe praktikave më të mira, për t'u angazhuar në mënyrë të efektshme me palët e interesit vendore dhe për të treguar vlerën e bashkëpunimit.

Histori e Vullnetarit: Një qendër sportive e projektuar nga komuniteti

Në Shqipëri, nxënësit, mësuesit dhe anëtarët e komunitet bashkuan forcat me Vullnetarin e Korpusit të Paqes Jay për të transformuar shkollën e tyre në një qendër aktive për aktivitete sportive dhe aktivitete pas shkollës.

Me një grant të projektuar nga komuniteti, për të cilin Vullnetari i Korpusit të Paqes Jay ndihmoi në mbledhjen e burimeve, shkolla përfitoi pajisje të reja sportive që rigjallëruan orët mësimore të edukimit fizik nga kopshti deri në klasën e nëntë dhe që energjizuan të gjithë fshatin. Nxënësit tani po udhëheqin ekupe, po mësojnë bashkëpunim dhe po zbulojnë pasione të reja, ndërsa mësuesit forcojnë aftësitë e tyre në planifikim dhe menaxhim projektesh. Shkolla madje ka filluar të organizojë evente komunitare dhe shpreson t'i zgjerojë ato në turne ndërshkollore. Ky projekt i drejtuar në nivelin vendor tregon se si investimet e vogla mund të nxisin ndryshime afatgjata.



Ky bashkëpunim rigjallëroi orët e edukimit fizik dhe energjizoi të gjithë komunitetin.

Vullnetarët ndajnë kulturën dhe traditat amerikane

MIRËNJOHJA NË KLASA

Vullnetarja e Korpusit të Paqes Rylie solli pak nga fryma e Falënderimeve në klasën e saj shqiptare. Së bashku me nxënësit e saj vizatuan gjela deti duke përdorur formën e dorës së tyre dhe ndanë se për çfarë dhe pse janë mirënjohës. Një aktivitet i thjeshtë që buron nga zemra i cili nxiti dialogun kuptimplotë dhe shkëmbimin kulturor. 🇺🇸

KONKURSI I GËRMËZIMIT

Vullnetarët e Korpusit të Paqes Katerina dhe CJ bashkuan forcat me mësuesit vendas për të organizuar një konkurs gërmëzimi rajonal dhe duke bërë bashkë nxënësit për të festuar të nxënit dhe dashurinë për gjuhën. Me shokët e tyre të klasës që brohorisnin dhe prindërit krenarë energjia ishte e pabesueshme teksa nxënësit po shfaqnin me vetëbesim punën e tyre të palodhur. Urime për të gjithë ata që morën pjesë dhe e bënë këtë një ditë të paharrueshme! ❤️ 🎉



Këto aktivitete kontribuojnë në forcimin e shkëmbimit kulturor dhe lidhjet e komunitetit.

Vullnetarët përfshihen në jetën dhe kulturën vendase

Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi mbështet Vullnetarët në fuqizimin e zërave të vendit pritës dhe nxitjen e respektit të ndërsjellë nëpërmjet nismave të drejtuara në nivel vendor. Duke ndarë historitë e ndikimit në evidentojmë bashkëpunimin me komunitetet dhe promovojmë të kuptuarit më të mirë të popujve të tjerë nga amerikanët.

Përkufizimi i ri i suksesit në Kukës

Kur një Vullnetar i Korpusit të Paqes mbërriti fillimisht në Kukës, në veriun e Shqipërisë, projektet e hershme hasën vështirësi në avancim. Përpjekjet për hapjen e një kursi të gjuhës angleze dhe klubi i Modelit të BE-së u zbehën duke nxitur reflektimin se çfarë do të thotë suksesi i vërtetë në zhvillimin e komunitetit.

Një ide nga komuniteti solli ndryshimin

Pika e kthesës erdhi kur drejtuesit vendas propozuan organizimi e një gjysmë maratone për të promovuar turizmin në qark. Vullnetari kaloi nga drejtues i projekteve në një mbështetës të vizionit të drejtuar nga komuniteti. Në bashkëpunim me bashkinë, OJQ-të vendore, shkollat dhe bizneset eventit u kthye në një bashkëpunim të madh ku u përfshinë pothuajse 100 vullnetarë vendas.

Ndikimi përtej vijës së finishit

Gjysmë maratona e Kukësit tërhoqi 200 vrapues nga gjashtë vende, gjeneroi mbi 400,000 shikime në mediat sociale dhe tërhoqi vëmendjen e mediave kombëtare. Festa përfundoi me vallen tradicionale të Kukësit nën banderolën e maratonës — një simbol i fuqishëm i unitetit dhe krenarisë kulturore. Kjo histori ilustron se si të dëgjuarit dhe partneriteti sjellin ndikime afatgjata.



Stafi ynë i përherëshëm gjatë vitit 2025

Korpusi i Paqes Shqipëri dhe Mali i Zi krenohet me stafin e dedikuar të përbërë nga amerikanë, shqiptarë dhe malazezë, ndër më të talentuarit e të dyja vendeve ku shërbejmë. Ekipi ka në fokus ofrimin e ndihmës për Vullnetarët tanë në mënyrë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë gjatë shërbimit. Ata janë të emocionuar për punën e tyre dhe që do të bëjnë diferencën për fëmijët, komunitetet dhe njerëzit në Shqipëri dhe Mal të Zi. Ky është ekipi përgjegjës për punën e mirë që kemi bërë në Shqipëri që nga viti 1992 dhe për menaxhimin e mundësisë së re për të shërbyer në Mal të Zi.

Admir Gjoni
Agim Dyrmishi
Arben Cako
Arben Loci
Ardita Qosja
Artenca Collaku
Benard Babaj
Besa Arapi
Darina Kaltani
Diana Djaloshi
Dorontinë Berishaj
Elsona Tuncer
Florian Muhaj
Geri Martiri
Ilir Memlikaj
Ilir Ziu
Iris Dollia
Ivana Rackovic
James Ayres
Jelena Tripkovic

Julian Pando
Luka Bobicic
Lumturi Piciri
Marie Aughenbaugh
Marjeta Zavalani
Megan Wilson
Milena Pejovic
Mira Luca
Mirela Tahiraj
Monika Mukja
Qazim Hoxha
Suida Shima
Tiana Covic
Ylli Cupi



Anëtarët e stafit në një event për zhvillimin e ekipit në prill të vitit 2025

Organizatat Partnere të KPSHMZ-së

Organizata jo qeveritare (OJQ)	Organizata qeveritare dhe të pavarura
<ul style="list-style-type: none"> • Agro-Puka • Fondacioni i Zhvillimit të Kapaciteteve Vendore Shqiptare • Këshillat Amerikanë • Qendra ARKA-Shkodër • CSDC Durrës • Darien Book Aid • Shoqata e Mësuesve të Gjuhës Angleze • Unioni i Anglishtfolësve • Fondacioni Food Bank Albania • Friends of Albania • Junior Achievement Shqipëri • Mary Ward Loreto • Fëmijët janë e ardhmja (FJA) • Qendra Konsumatori Shqiptar (QKSH) • New Bridges • Qendra “Marrëdhënie” • Agjencia e Zhvillimit Rajonal-Korçë • Sidi Education • Terre des Hommes • Touristic Dibra • Water Charity • World Association of Girl Guides and Girl Scouts • World Connect • World Vision • Qendra rinore —Vlorë • Youth in Free Enterprise 	<ul style="list-style-type: none"> • Ministria e Arsimit dhe Sporteve • Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Inovacionit e Malit të Zi • ASCAP (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar - Shqipëri) • DPAP(Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar - Shqipëri) • Drejtoria Arsimore e Rajonit të Veriut, Shqipëri • Projekti “Shëndet për të Gjithë” - Shqipëri • Shoqata e Paraplegjikëve e Malit të Zi • Instituti Shqiptar i Shëndetit Publik • Forum MNE • Shoqata e Mësuesve të Gjuhës Angleze e Malit të Zi • Ministria e Punëve të Jashtme e Malit të Zi • Ministria e Punëve të Brendshme e Malit të Zi • Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) në Shqipëri dhe Mal të Zi • Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë • Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar • Ambasadat e Shteteve të Bashkuara në Shqipëri dhe Mal të Zi dhe Këndet Amerikane • Universiteti i Shkodrës, Departamenti i Gjuhës Angleze • Universiteti i Tiranës, Departamenti i Gjuhës Angleze
Bashkitë dhe shkollat	
<p>Shprehim vlerësimet tona për shkollat dhe bashkitë partnere në Shqipëri dhe në Mal të Zi.</p>	

Organizatat Partnere të KPSHMZ-së

Organizata jo qeveritare (OJQ)

- Qendra Epoka e Re
- Qendra Mjedisore Për Studime dhe Zbatime
- SOS Fshatrat e Fëmijëve - Tiranë dhe Shkodër
- Tjetër Vizion
- Open Gov Hub Albania
- Shoqata e Zhvillimit të Lidershipit për Ballkanin
- Qendra Psiko-Sociale “Vatra”
- Agjencia e Zhvillimit Rajonal
- Argonaut - Tepelenë
- Përfshirja Sociale për Zhvillim
- Qendra “Lëvizja Rinore”
- Qendra Internacionale për Solidaritet
- Youth of Ura
- Qendra Komunitare Nishtulla
- Udhëtim i Lirë – Liberi di Viaggiare
- Me Komunitetin për Ndryshim
- Porta Rome për Integrim







Zyra e KPSHMZ-së në Shqipëri

Rr. Besnik Sykja, Godina 2
Hyrja 1, Kutia Postare 8180
Tiranë, Shqipëri.
Tel: +355 42 365 5033

Zyra e KPSHMZ-së në Mal të Zi

Vaka Djurovica bb, stadion pod Goricom,
sjeverna tribina 81000,
Podgoricë, Mali i Zi.
Tel: +382 (0) 20674509

Faqja e internetit:

peacecorps.gov/albania-and-montenegro/

Facebook:

facebook.com/albania.peacecorps
facebook.com/peacecorpsinmontenegro

Instagram:

na gjeni duke kërkuar: [@peacecorpsalbania](https://www.instagram.com/peacecorpsalbania)
na gjeni duke kërkuar:
[@peacecorpinmontenegro](https://www.instagram.com/peacecorpinmontenegro)

E-mail:

AL-information@peacecorps.gov